



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 106, Datë 23.03.2023

MBI

**MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË RREGULLAT E TREGUT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, TË MIRATUARA ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE NR. 347, DATË
27.12.2022**

Në mbështetje të neneve 16; 18, pika 1, gërma “a” dhe “dh”; nenit 19 gërma “a”, neneve 57 dhe 98 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 519, datë 13.07.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike” si dhe nenit 26 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.03.2023, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Grupi i Punës, me nr. 1097/1prot., datë 21.03.2023 “Mbi miratimin e disa shtesave në rregullat e tregut të energjisë elektrike, të miratuara me vendimin e bordit të ERE nr. 347, datë 27.12.2022”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 347, datë 27.12.2022, vendosi të miratojë Rregullat e tregut të energjisë elektrike (rregullat e ALPEX, përkufizimet, procedura e tregtimit si dhe procedura e klerimit dhe shlyerjes).
- Me miratimin e këtyre rregullave dhe parashikimin e shoqërisë ALPEX sh.a. për fillimin e fazës operacionale go-live të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a. më datë 31.03.2023, lind nevoja për miratimin e disa shtesave në këto rregulla, me qëllim saktësimin e disa prej procedurave të parashikuara në to. Për këtë qëllim, shoqëria ALPEX sh.a. me shkresat nr. 253, 254, 255, 256, 257 prot., datë 03.11.2022 dhe nr. 263 prot., datë 15.11.2022 ka paraqitur në ERE disa propozime për miratimin e disa shtesave shkresa të cilat janë publikuar për konsultim në faqen e internetit të ERE.
- Në vijim të vendimit të bordit të ERE nr. 272, datë 27.10.2022 të fillimit të procedurave për miratimin e Rregullave të tregut të energjisë elektrike dhe vendimit të bordit të ERE nr. 347, datë 27.12.2022 për miratimin e tyre, Grupi i Punës, pas shqyrtimit të këtyre propozimeve ka vlerësuar që propozimet e ardhura nga shoqëria ALPEX sh.a. të trajtohen si shtesa në formën e anekseve të “Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike”, të miratuara me vendimin e bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022, me qëllim që të mos çenojnë funksionimin e rregullave të miratuara, për shkak se disa prej anekseve do të jenë të vlefshme për një periudhë tranzitore dhe mund të jenë objekt ndryshimi herë pas here.

- Nga ERE, më datë 21.02.2023 është zhvilluar një seancë dëgjimore në vazhdimësi të procesit të konsultimeve publike në kuadër të miratimit të rregullave të tregut, për të konkluduar mbi këto propozime të paraqitura nga shoqëria ALPEX sh.a., mes përfaqësuesve të ALPEX sh.a., dhe palëve të interesuara. Në këtë seancë dëgjimore, nga palët e interesuara mori pjesë vetëm Shoqata e Furnizuesve Shqiptar të Energjisë Elektrike.
- Rezulton se, me përcjelljen nga ALPEX sh.a. të drafteve përfundimtare të këtyre propozimeve më datë 06.03.2023 dhe Shoqata e Furnizuesve Shqiptar të Energjisë Elektrike (AAES) ka konfirmuar nëpërmjet komunikimeve elektronike dakordësinë me përmbajtjen e tyre. Të njëjtat Rregulla janë dërguar për miratim dhe Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) së Kosovës e cila pritet t'i miratojë këto shtesa gjatë muajit Mars 2023. Shtesat e propozuara nga shoqëria ALPEX sh.a., janë trajtuar në 7 (shtatë) anekse si më poshtë të listuara, të cilat kanë qënë pjesë e konsultimeve publike me palët e interesit dhe ERE-n me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 272 datë 27.10.2022 dhe janë pjesë integrale të rregullave të tregut të energjisë elektrike të miratuara me vendimin e bordit të ERE nr. 347/2022.
 - Aneksi nr. 1, përmban *marrëveshjen e anëtarësimit në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike*, e cila përbëhet nga 15 pika dhe ka për qëllim të rregullojë marrëdhëniet ndërmjet palëve si dhe të drejtat e detyrimet e secilit prej tyre në momentin e anëtarësimit në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike.
 - Aneksi nr. 2, përmban *çmimet maksimale dhe minimale të urdhërporosive për tregun e ankandëve të ditës në avancë*.
 - Aneksi nr. 3, përmban *portofolet e anëtarëve të bursës që do trajtohen me urdhërporosi marrëse e çmimit me përparësi (shitje/blerje) dhe renditjen e tyre sipas prioritetit në tregjet e ankandëve të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë në bursën shqiptare të energjisë elektrike*.
 - Aneksi nr. 4, përmban *rregullin për përcaktimin e urdhërporosive fituese në rastin kur një segment i grupuar i urdhërporosive shitjeje/blerjeje do të pranohet pjesërisht*.
 - Aneksi nr. 5, përmban *alokimin e portofoleve të veçanta në bursën shqiptare të energjisë elektrike për gjeneruesit me kapacitet të instaluar të barabartë ose më të madh se 5 MW*.
 - Aneksi nr. 6, përmban *rregullat mbi tregtimin e kontratave të lidhura ndërmjet dy pjesëmarrësve të tregut jashtë bursës (over the counter - otc) në bursën shqiptare të energjisë elektrike, midis shoqërive që nuk iu është vendosur detyrimi për shërbimin publik*.
 - Aneksi nr. 7, përmban *rregullat mbi produktet dhe llojet e urdhërporosive që do të tregtohen fillimisht në bursën shqiptare të energjisë elektrike*.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi

1. Miratimin e disa shtesave nën emërtimin anekset (bashkëlidhur dhe pjesë integrale e rregullave), në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuara me vendimin e bordit të ERE nr. 347, datë 27.12.2022, si më poshtë vijon:

Aneks nr. 1 – Marrëveshja e Anëtarësimit në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike.

Aneks nr. 2 – Çmimet maksimale dhe minimale të urdhërporosive për tregun e ankandeve të ditës në avancë.

Aneks nr. 3 –Portofolet e anëtarëve të bursës që do trajtohen me urdhërporosi marrëse e çmimit me përparësi (shitje/blerje) dhe renditjen e tyre sipas prioritetit në tregjet e ankandeve të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë në bursën shqiptare të energjisë elektrike.

Aneks nr. 4 – Rregulli për përcaktimin e urdhërporosive fituese në rastin kur një segment i grupuar i urdhërporosive shitjeje/blerjeje do të pranohet pjesërisht.

Aneks nr. 5 – Alokimi i portofoleve të veçanta në bursën shqiptare të energjisë elektrike për gjeneruesit me kapacitet të instaluar të barabartë ose më të madh se 5 MW.

Aneks nr. 6 – Tregtimi i kontratave të lidhura ndërmjet dy pjesëmarrësve të tregut jashtë bursës (over the counter - otc) në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike, midis shoqërive që nuk iu është vendosur detyrimi për shërbimin publik.

Aneks nr. 7 – Produktet dhe llojet e urdhërporosive që do të tregtohen fillimisht në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike.

2. Anekset nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, dhe 7 i bashkëlidhen këtij Vendimi.
3. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, AAES dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

RREGULLAT E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

ANEKS NR. 1

**MARRËVESHJA E ANËTARËSIMIT NË BURSËN SHQIPTARE TË
ENERGJISË ELEKTRIKE
PËR TREGUN SHQIPTAR**

nga dhe ndërmjet

ALPEX sh.a

dhe

XXXX (emri i Anëtarit të Bursës)

PALËT

Kjo Marrëveshje Anëtarësimi në Bursë (në vijim: **Marrëveshja**) është nënshkruar në datën më të fundit siç përcaktohet në faqen e nënshkrimeve, nga dhe ndërmjet

1. BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE SH.A një shoqëri e organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në Rrugën Liman Kaba , Residencia Olympic, Shkalla 3, Kati 1, zyra 1, Tiranë , Shqipëri, dhe e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NIPT M02223006B (në vijim: ALPEX), e përfaqësuar ligjërisht nga z. Sokol Dishnica.

dhe

2. XXX (Të dhënat e Anëtarit të Bursës)

të referuara bashkërisht si "Palët" dhe veçmas si "Pala".

Marrëdhëniet ndërmjet Palëve do të rregullohen nga kjo Marrëveshje dhe nga dokumentet e referuara në të.

1. Prioriteti i Dokumenteve:

1.1. Dokumentet që formojnë marrëveshjen kontraktuale do të konsiderohen si shpjeguese reciprokisht ndaj të njëra-tjetrës. Për qëllime interpretimi, siç shkruhet në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme, përparësia e dokumenteve do të jetë si më poshtë (bashkërisht referuar në vijim si "**Dokumentet** "):

- a) Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme;
- b) Procedurat siç janë të përcaktuara në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme;
- c) Marrëveshja e Anëtarësimit në Bursë; dhe
- d) Marrëveshja Kuadër për Klerim.

2. PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMET

2.1. Siç përdoret në këtë Marrëveshje, përveç rasteve kur shprehet ndryshe ose konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet e dhëna në Përkufizimet e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, njëjësi (ku është e përshtatshme) do të përfshijë shumësin dhe anasjelltas.

3. TË PËRGJITHSHME

3.1. ALPEX-i është operatori përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e tregjeve të energjisë elektrike të Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë (Tregjet e ALPEX-it) në Shqipëri bazuar në Licencën Nr. 525, Seria nr.O22, datë 29.09.2022 lëshuar nga ERE, në përputhje të plotë me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Procedurat.

3.2. Sipas Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike– Kushtet e Përgjithshme, çdo Anëtar i Bursës duhet të nënshkruajë një Marrëveshje me ALPEX-in për të kryer Tregtimin dhe transaksionet e lidhura me të, në një ose secilin prej Tregjeve të ALPEX-it.

- 3.3. Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, Anëtari i Bursës ka të drejtë të kryejë Tregtime dhe Transaksione në Tregjet e ALPEX-it. Tregtimi dhe transaksionet janë subjekt i dispozitave të Dokumenteve.
- 3.4. Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, Anëtari i Bursës pranon të jete subjekt i, dhe të përmbushë detyrimet që lindin nga Dokumentet e renditura në klauzolën 1.1 të kësaj Marrëveshjeje, siç ndryshohet herë pas here nga ALPEX-i, si dhe nga ndonjë vendim i çdo natyre (përfshirë vendimet teknike), mase dhe akti dhe/ose dokumenti të miratuar ose të lëshuar nga ALPEX-i bazuar në, në zbatimin të, ose referuar në, këto Dokumenta.
- 3.5. Të drejtat e aksesit të Anëtarit të Bursës në Tregjet e ALPEX-it përcaktohen në Aneksin 1 të kësaj Marrëveshjeje.
- 3.6. Anëtari i Bursës pranon shprehimisht dhe njeh, se të gjitha Tregtimet dhe Transaksionet përkatëse, përsa i përket shitjes dhe blerjes, pagesat dhe dorëzimin, transferimin e titullit të energjisë elektrike dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me transaksione të tilla krijohen dhe finalizohen, dhe për këtë arsye bëhen të detyrueshme për palët e transaksionit, me ane të zhvillimit të ankandëve ose nga përputhja e Urdhërporosive në Tregimin e Vazhdueshëm si dhe me njoftimin nga ETSS tek EMCS të kësaj përputhjeje, duke krijuar rrjedhimisht një Kontratë të zbatueshme sipas parashikimeve të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Procedurat.
- 3.7. Anëtari i Bursës pranon të paguajë çdo tarifë fikse, tarifë variabël, interes të vonuar ose çdo taksë të zbatueshme sipas parashikimeve Ligjore, në varësi të rastit, që parashikohet ose përcaktohet në bazë të dispozitave të Dokumenteve;
- 3.8 Anëtari i Bursës merr përsipër që për të gjithë kohëzgjatjen e kësaj Marrëveshjeje do të angazhojë në procedurat e Tregtimit dhe Transaksioneve vetëm personel të trajnuar dhe të çertifikuar siç duhet, sipas kërkesave të Dokumenteve;
- 3.9 Anëtari i Bursës pranon të krijojë, regjistrojë dhe përsosë në favor të ALPEX-it të gjitha të drejtat e nevojshme që jepen në favor të palëve të treta, mbi kolateralin dhe marzhin sic parashikohet në Dokumenta;
- 3.10 Anëtari i Bursës pranon dhe autorizon ALPEX-in ose Anëtarin e tij të Përgjithshëm të Klerimit për të aplikuar çdo netim ose kompensim për detyrimet financiare të Anëtarit të Bursës që rrjedhin nga transaksionet e tij;
- 3.11 Palët bien dakord që pagesat ndërmjet tyre si rezultat i transaksioneve të kryera në Tregjet e ALPEX-it, pavarësisht se në cilin segment të tregut janë lidhur, do të shlyhen me ane të kompensimit të pagesave e detyrimeve të ndërsjellta;
- 3.12 Anëtari i Bursës pranon që, për të patur akses në Tregjet e ALPEX-it, do të përmbushë dhe do të jetë në përputhje me të gjitha kërkesat e legjislacionit Shqiptar, dispozitave të kuadrit Rregullator të Energjisë, të Dokumenteve, si dhe me kërkesat e lidhura tregtare dhe të gjitha detyrimet përkatëse, të përcaktuara në Dokumenta dhe në këtë Marrëveshje;
- 3.13 ALPEX-i pranon të sigurojë akses në Tregjet e ALPEX-it në përputhje me ligjet dhe rregulloret përkatëse në fuqi dhe në veçanti me detyrimet përkatëse sipas pikës 3.1 dhe Dokumenteve dhe do t'i përmbahet kërkesave dhe detyrimeve tregtare siç përcaktohet në këtë Marrëveshje.
- 3.14 Në rastet kur Anëtari i Bursës dëshiron të ndërmarrë tregtimin nëpërmjet një portofoli OTC në Tregjet e ALPEX-it, atëherë Anëtari i Bursës duhet të lidhë një marrëveshje të veçantë me ALPEX-in për këtë qëllim dhe kjo marrëveshje do të miratohet paraprakisht nga Autoriteti Rregullator.

3.15 Në rast të shkeljes së kësaj Marrëveshjeje dhe dispozitave të Dokumenteve, pala shkelëse do të jetë përgjegjëse për kompensimin e dëmeve të shkaktuara palës tjetër, në përputhje me dhe brenda kufizimeve të përcaktuara në Dokumente.

4. HYRJA NË FUQI

4.1 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi me nënshkrimin ("Data e Fillimit") dhe do të mbetet në fuqi deri në përfundimin e saj, në përputhje me seksionin 9 ("Përfundimi") të kësaj Marrëveshjeje. Në rast se palët nuk nënshkruajnë në të njëjtën datë, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën më të fundit të nënshkrimit.

5. SJELLJA NË TREG E ANËTARIT TË BURSËS

5.1 Duke respektuar kërkesat për transparencë dhe gjatë ushtrimit të kompetencave të monitorimit të Tregut të Energjisë Elektrike, ALPEX-i ka të drejtë dhe detyrohet të monitorojë dhe sanksionojë çdo Anëtar të Bursës që nuk respekton Dokumentet dhe kërkesat Rregullatore.

5.2 ALPEX ka të drejtë të publikojë dhe të zbulojë çdo fakt në lidhje me shkeljen e Dokumenteve nga Anëtarët e Bursës.

6. DEKLARIMET

6.1. Deklarimet nga Anëtari i Bursës

6.1.1 Anëtari i Bursës deklaron dhe garanton ALPEX-in se:

- a. është krijuar dhe ekziston/funksionon sipas ligjeve në fuqi të vendit ku është themeluar dhe veprimtaria e tij ndiqet në bazë të licencave ekzistuese dhe/ose miratimeve dhe/ose autorizimeve dhe/ose lejeve, sipas rastit;
- b. është në gjendje të mirë dhe nuk ka rrethana ligjore, teknike dhe financiare ekzistuese ose që mund të ekzistojnë në aktivitetin e tij tregtar, të cilat do të pengonin ose ndalonin nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, pajtueshmërinë dhe zbatimin e dispozitave të saj dhe përputhshmërinë dhe zbatimin e dispozitave të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Procedurat.
- c. të gjitha informacionet, deklaratat dhe angazhimet e dhena ose të bëra pjesë e aplikimit për t'u pranuar si anëtar i bursës dhe/ose të dhena ose të bashkëngjitura tek çdo aplikim tjetër, çertifikim, procedura që lidhen me marrjen e një miratimi, pëlqimi ose autorizimi, ose si pjesë e çdo komunikimi tjetër të çdo forme me ALPEX-in, me qëllim pjesëmarrjen dhe/kryerjen e Tregtimit, janë të vërteta, korrekte dhe detyruese;
- d. Marrëveshja Kuadër e Klerimit me Anëtarin e Drejtpërdrejtë të Klerimit ose Anëtarin e Përgjithshëm të Klerimit sipas rastit, është lidhur me ALPEX-in në përputhje me Dokumentet;
- e. ai njeh dhe kupton karakteristikat e çdo Produkti dhe të Tregtimit dhe rreziqet që lidhen me të;
- f. ai i kupton të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje dhe pjesëmarrja e tij në këtë Marrëveshje do të interpretohet si pjesëmarrja e një pale tregtare e cila ka të gjitha njohuritë dhe informacionin kontraktual dhe të industrisë, që një kompani që operon në

një treg të energjisë elektrike dhe aktivitet tregtar duhet të ketë, dhe pranon se pozicioni kontraktual në asnjë rast nuk do të jetë ose interpretohet si një pozicion kontraktual konsumator.

- g. ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të autorizuar nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje të plotësuar nga Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Procedurat; dhe
 - h. nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje dhe pajtueshmëria e tij me këtë Marrëveshje dhe Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme nuk çënon asnjë ligj, rregull, rregullore, marrëveshje, dokument ose instrument detyrues ose të zbatueshëm për Anëtarin e Bursës.
- 6.1.2 Anëtari i Bursës konsiderohet se pranon dhe përsërit Deklarimet dhe Garancitë që përmbahen në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme.
- 6.1.3 Anëtari i Bursës konsiderohet se përsërit Deklarimet dhe Garancitë sipas klauzoleve nga 6.1.1 tek 6.1.3 të kësaj Marrëveshjeje sa herë që dorëzon një urdhërporosi, ofertë, kërkesë dhe/ose çdo herë që fillon një Transaksion dhe/ose lidh një Kontratë sipas Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe Rregullave e Tregut të Energjisë Elektrike – Procedurat. Anëtari i Bursës pranon se këto deklarime dhe garanci, që janë të vërteta dhe të sakta, konsiderohen si kushte thelbësore për qëllimin dhe vullnetin e ALPEX-it për të hyrë në këtë Marrëveshje me Anëtarin e Bursës.
- 6.1.4 Anëtari i Bursës pranon se është i detyruar të njoftojë menjëherë ALPEX në rast se vihet në dijeni për ndonjë shkelje të një Deklarimi ose Garancie, siç parashikohet më tej në Rregullat e ALPEX-it. Mospërbushja e një njoftimi të tillë nga Anëtari i Bursës do të rezultojë në detyrimin e Anëtarit të Bursës për të zhdëmtuar të gjitha kostot dhe dëmet e shkaktuara ndaj ALPEX-it, si dhe në ndodhjen e Ngjarjes së Papajtueshmërisë ose Ngjarjes Materiale të Papajtueshmërisë, sipas rastit.

6.2. *Deklarime nga ALPEX-i*

- 6.2.1. Duke hyrë në këtë Marrëveshje, ALPEX-i deklaron dhe garanton për Anëtarin e Bursës që:
- a. ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të autorizuar nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, siç parashikohet nga Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Procedurat përkatëse; dhe
 - b. nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje dhe zbatimi i saj sipas kësaj Marrëveshjeje dhe Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme nuk çënon asnjë ligj, rregull, rregullore ose marrëveshje, dokument ose instrument detyrues ose të zbatueshëm për ALPEX-in.

7. **KONFIDENCIALITETI**

- 7.1. ALPEX-i do të sigurojë që asnjë palë e tretë të mos ketë akses ose njohuri për ndonjë çështje në lidhje me biznesin ose çështjet personale të Anëtarit, për të cilat merr dijeni nëpërmjet transaksioneve të Anëtarit të Bursës në Tregjet e ALPEX-it, dhe ALPEX-i nuk do ta përdorë këtë informacion për qëllime të tjera përveç atyre që lidhen me transaksionet në Tregjet e ALPEX-it dhe aktivitetet e lidhura me ALPEX-in.
- 7.2. Anëtari i Bursës merr përsipër që në asnjë moment të mos i zbulojë asnjë personi ndonjë informacion konfidencial në lidhje me biznesin, punët, klientelën, klientët ose

anëtarët e tjerë të ALPEX-it.

7.3. Pavarësisht nga dispozitat e tjera të këtij Seksioni 7:

- a. Anëtari i Bursës pranon se ALPEX-it do t'i lejohet t'i japë informacion lidhur me të dhënat e volumeve të tregtuara (por jo çmimet e tyre) çdo personi ose subjekti tjetër që këshillon ose ndihmon ALPEX në operacionet e tij. Në transaksionet që përfshijnë ndonjë transferim/shitje të ardhshme të biznesit/kapitalit, nuk ka kufizime lidhur me informacionin e dhënë, me kusht që këta persona dhe subjekte t'i nënshtrohen një detyrimi përkatës të konfidencialitetit.
- b. Anëtari i Bursës njuh të drejtat e ALPEX për të përdorur dhe shpërndarë informacionin e Transaksioneve siç përcaktohet në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme.
- c. detyra e konfidencialitetit nuk do të shtrihet në informacionin që është, ose bëhet publik, për shkak të mos shkeljes së detyrimeve të konfidencialitetit të një Pale sipas këtij ligji.
- d. secila Palë do të lejohet të zbulojë çdo informacion që mund të kërkohet nga ligji në fuqi, urdhri i gjykatës ose një kërkesë nga çdo Autoritet qeveritar ose Rregullator brenda territorit ku ALPEX-i operon; dhe
- e. asnjëra nga Palët nuk është e detyruar të mbajë konfidenciale faktin që ka hyrë në këtë Marrëveshje apo faktin që Marrëveshja ka pushuar së ekzistuari ose ka përfunduar.

7.4. Ky Seksion nuk do të kufizojë detyrimet e asnjërës Palë për konfidencialitetin sipas Ligjit të Zbatueshëm.

8. NDRYSHIMET NË MARRËVESHJE

- 8.1. Përveç asaj që parashikohet në paragrafin 8.2 më poshtë, çdo Ndryshim i kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë ndryshimet në Aneksin e saj, kërkon miratimin e Autoritetit Rregullator, sipas rastit.
- 8.2. Çdo ndryshim i Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike dhe ndryshimet në legjislacionin parësor dhe dytësor si dhe në aktet rregullatore do t'i zbatohen automatikisht kësaj Marrëveshje dhe ALPEX-i do të njoftojë ndryshimet tek Anëtari i Bursës. Anëtari i Bursës duke nënshkruar këtë Marrëveshje pranon, njuh dhe bie dakord me ndryshimet sipas këtij paragrafi dhe sipas Marrëveshjes siç ajo do të amendohet nga çdo ndryshim i tillë herë pas here.

9. ZGJIDHJA E MARRËVESHJES

9.1. *Përfundimi për shkak të Dorëheqjes së Anëtarit të Bursës*

- 9.1.1. Kjo Marrëveshje mund të ndërpritet në mënyrë të njëanshme nga Anëtari i Bursës në përputhje me dispozitat për dorëheqjen e Anëtarit të Bursës siç përcaktohet në Dokumentet;

9.2. *Përfundimi nga ALPEX*

- 9.2.1 Kjo Marrëveshje mund të përfundojë në mënyrë të njëanshme nga ALPEX-i:

a) çdo herë që ALPEX lëshon një Urdhër Përfundimi, sipas Dokumenteve;

9.3. Në çdo rast, nëse përfundimi është shkaktuar për shkak të shkeljes së kësaj Marrëveshjeje dhe të dispozitave të Dokumenteve, pala shkelëse do të jetë përgjegjëse për kompensimin e dëmeve të shkaktuara palës tjetër, në përputhje me dhe brenda kufizimeve të përcaktuara në Dokumentet.

10. FORCA MADHORE

10.1. Asnjëra palë nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë dështim të plotë ose të pjesshëm, apo vonesë në kryerjen e detyrave të saj sipas kësaj Marrëveshjeje (përveçse vonesës në pagesën e detyrimeve të bëra të pagueshme) në masën që dështimet ose vonesat janë shkaktuar nga Forca Madhore, duke përfshirë: pa kufizim, dështimi i Palës, ose i ndonjë pale tjetër që vepron në emër të saj, për të përmbushur në mënyrë thelbësore detyrimet e saj të performancës sipas kësaj Marrëveshjeje.

10.2. Pala e prekur nga ngjarja e Forcës Madhore do të përdorë përpjekje të arsyeshme për të zbutur efektin e saj në Marrëveshje dhe për të përmbushur detyrimet e saj sipas Marrëveshjes, por pa cenuar të drejtën e secilës palë për të përfunduar Marrëveshjen sipas seksionit 8 më sipër.

10.3. Si kusht për pretendimin për mospërgjegjësi, Pala që përjeton vështirësi në zbatim do t'i japë Palës tjetër njoftim të menjëhershëm me shkrim, me detaje të plota pas shfaqjes së shkakut në të cilin mbështetet. Datat në të cilat janë planifikuar të përmbushen detyrimet e performancës do të zgjaten për një periudhë të barabartë me kohën e humbur për shkak të çdo vonese të shkaktuar.

11. TË NDRYSHME

11.1. Njoftimet

11.1.1. Çdo njoftim që kërkohet të jepet sipas kësaj Marrëveshjeje ose Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Procedurat nga Anëtari i Bursës do t'u jepet me shkrim nga Palët ose përfaqësuesit e autorizuar të palëve, përfaqësuesve të autorizuar të ALPEX-it, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Procedurat.

11.2. Marrëveshja e plotë

11.2.1. Kjo Marrëveshje dhe Dokumentat përbëjnë të gjithë marrëveshjen midis ALPEX-it dhe Anëtarit të Bursës në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshjeje dhe të Dokumentave, dhe ato zëvendësojnë çdo marrëveshje ose mirëkuptim të mëparshëm ndërmjet tyre në lidhje me këtë temë.

11.2.2. ALPEX-i dhe Anëtari i Bursës pranojnë secili se, me lidhjen e kësaj Marrëveshjeje, nuk janë mbështetur dhe nuk do të kenë të drejtë apo mjete juridike në lidhje me ndonjë deklaratë, përfaqësim, siguri ose garanci, përveç siç përcaktohet shprehimisht në këtë Marrëveshje dhe Dokumentet.

11.2.3. Asgjë në këtë seksion nuk do të kufizojë ose përjashtojë asnjë përgjegjësi të Palëve për mashtrim.

11.3. Ndarshmëria

11.3.1. Në rast se një ose më shumë dispozita të kësaj Marrëveshjeje për çfarëdo arsye do të konsiderohet e pavlefshme, e paligjshme ose e pazbatueshme, dispozitat e mbetura do të mbeten të vlefshme dhe të zbatueshme.

11.4. *Cedimi*

11.4.1. Anëtari i Bursës nuk mund të transferojë, zëvendësojë ose cedojë këtë Marrëveshje ose ndonjë të drejtë që rrjedh nga kjo Marrëveshje ose sipas Dokumenteve pa pëlqimin paraprak me shkrim të ALPEX-it.

11.5. *Kopjet*

11.5.1. Kjo Marrëveshje mund të ekzekutohet në çdo numër kopjesh, secila prej të cilave kur ekzekutohet do të përbëjë një origjinal të kësaj Marrëveshjeje, por të gjitha kopjet së bashku do të përbëjnë të njëjtën marrëveshje.

11.5.2. Kjo Marrëveshje është lidhur në gjuhën shqipe ose angleze. Pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje janë Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Procedurat.

11.6. *Heqja dorë*

11.6.1. Asnjë dështim ose vonesë nga një palë për të ushtruar ndonjë të drejtë ose mjet juridik të parashikuar sipas kësaj Marrëveshjeje ose me ligj nuk do të përbëjë heqje dorë nga ajo ose nga ndonjë e drejtë ose mjet tjetër juridik.

12. KOMUNIKIMET

12.1. Çdo komunikim ndërmjet palëve, në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, duhet të dërgohet me shkrim; me mjetet e përcaktuara në nenin 12.2 të kësaj Marrëveshjeje.

12.2. Komunikimi ndërmjet palëve mund të bëhet me telefon, ose me e-mail, me kusht që të ketë një vërtetim me shkrim të marrjes.

12.3. Personi Përgjegjës për Tregtimin është personi i caktuar nga Anëtari i Bursës për përfaqësimin në emër të Anëtarit të Bursës në ALPEX. Personi Përgjegjës për Tregtimin do të njoftojë Anëtarin e Bursës për çdo rast dhe problem në lidhje me ALPEX-in. Ai do të veprojë si personi i kontaktit për të gjithë komunikimin ndërmjet palëve. Anëtari i Bursës mund të ndryshojë Personin Përgjegjës për Tregtimin, me anë të një njoftimi me shkrim për ALPEX-in.

12.4. Sipas Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme, Anëtarët e Bursës duhet të caktojnë të paktën një (1) Agjent Tregtar të Certifikuar për Tregtimin e Anëtarit të Bursës në Tregjet e ALPEX-it ku ai merr pjesë, me kusht që të miratohet nga ALPEX-i, miratim i cili nuk do të ndalohet në mënyrë të paarsyeshme. Agjenti Tregtar i Certifikuar mund të jetë gjithashtu i njëjti person si Personi Përgjegjës për Tregtimin. Të dhënat personale të Personit Përgjegjës për Tregtimin do të regjistrohen në Aneksin 2 të kësaj Marrëveshjeje. Anëtari i Bursës duhet të sigurojë që Agjenti Tregtar i Certifikuar do të autorizojë ALPEX për përpunimin dhe trajtimin e të dhënave personale duke nënshkruar autorizimin përkatës të dhënë nga ALPEX për këtë qëllim.

13. TË DREJTAT E ALPEX PËR PEZULLIMIN E ANËTARIT TË BURSËS NGA TREGJET E ALPEX-IT

- 13.1. ALPEX-i do të ruajë të drejtën për të pezulluar Anëtarin e Bursës nga Tregjet e ALPEX-it nëse:
- (i) është udhëzuar ta pezullojë anëtarin nëpërmjet një udhëzimi nga ERE dhe/ose OST;
 - (ii) Anëtari i Bursës ka shkelur detyrimet kryesore sipas Dokumenteve ose kësaj Marrëveshjeje.

14. ZGJEDHJA E LIGJIT

- 14.1. Kjo Marrëveshje do të drejtohet nga, interpretohet dhe do të hyjë në fuqi në përputhje me legjislacionin shqiptar.

15. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 15.1 Secila palë do të ketë të drejtën të fillojë procedurat e zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme, përsa i përket mosmarrëveshjeve që lidhen me çështjet që rrjedhin nga interpretimi dhe përmbushja e të drejtave dhe detyrimeve të kësaj Marrëveshjeje.
- 15.2 Nëse palët dështojnë të arrijnë zgjidhjen e Mosmarrëveshjes brenda Kalendarit të Procesit të Zgjidhjes së kësaj Mosmarrëveshjeve sipas Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, kjo Mosmarrëveshje do të dërgohet për shqyrtim pranë Autoritetit Rregullator përkatës dhe do të shqyrtohet sipas procedurave të përcaktuara në “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”.
- 15.3 Palët bien dakord që vetëm pasi të kenë shteruar procedurat sipas 15.1 dhe 15.2, ato do ta paraqesin mosmarrëveshjen pranë gjykatave kompetente të Tiranës që kanë juridiksion ekskluziv përfundimtar për të zgjidhur çdo pretendim, mosmarrëveshje ose dallim që mund të lindë nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje, duke përfshirë çdo pyetje në lidhje me ekzistencën, vlefshmërinë ose përfundimin e saj.
- 15.4 Secila Palë heq dorë në mënyrë të parevokueshme nga çdo kundërshtim që mund të ketë tani ose në vijim për caktimin e vendit të çdo procesi në Shqipëri dhe çdo pretendimi se një proces i tillë është ngritur në një gjykatë të papërshtatshme, dhe më tej pranon në mënyrë të parevokueshme se gjykimi në çdo procedurë të paraqitur në gjykatat shqiptare do të jetë përfundimtar dhe detyrues për këtë Palë dhe mund të zbatohet në gjykatat e çdo juridiksioni tjetër në përputhje me ligjin e atij juridiksioni.

* * *

NE DËSHMI TË MARRËVESHJES SË TYRE secila Palë ka autorizuar përfaqësuesin e saj për të ekzekutuar këtë Marrëveshje, e cila do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja Palët.

Kjo Marrëveshje është bërë në dy (2) origjinale në gjuhën e zgjedhur dhe secila Palë do të

mbajë një (1).

Për dhe në emër të Anëtarit të Bursës

Nënshkrimi dhe vula

Emri dhe funksioni (shkronja të mëdha)

Vendi

Data e nënshkrimit: _____

Për dhe në emër të ALPEX-it

Nënshkrimi dhe vula

Emri dhe funksioni (shkronja të mëdha)

Vendi

Data e nënshkrimit: _____

Aneksi 1 : Portofoli i Tregimit të Ditës në Avancë dhe Autorizimet e Anëtarëve për Tregtim dhe Klerim

Shtojca 2: Personi përgjegjës për tregtimin e Anëtarin të Bursës

1. Personi përgjegjës për tregtimin e Anëtarin të Bursës

		Kontakt alternativ
Emri i plotë dhe emërtimi		
Numrat e telefonave / celularëve të biznesit.		
Adresa e emailit të biznesit		
Numrat e Faksit të Biznesit.		

2. Agjenti Tregtar i certifikuar për Anëtarin e Bursës

		Kontakt alternativ
Emri i plotë dhe emërtimi		
Numrat e telefonave / celularëve të biznesit.		
Adresa e emailit të biznesit		
Numrat e Faksit të Biznesit.		

RREGULLAT E TREGUT TË ENERGISË ELEKTRIKE

ANEKS NR. 2

ÇMIMET MAKSIMALE DHE MINIMALE TË URDHËRPOSIVE PËR TREGUN E ANKANDEVE TË DITËS NË AVANCË.

1. Çmimi i lejuar Minimal për Ankandin e Tregut të Ditës në Avancë të jetë: **-500€/MWh**
2. Çmimi i lejuar Maksimal për Ankandin e Tregut të Ditës në Avancë të jetë: **4,000€/MWh.**

RREGULLAT E TREGUT TË ENERGISË ELEKTRIKE

ANEKS NR. 3

PORTOFOLET E ANËTARËVE TË BURSËS QË DO TRAJTOHEN ME URDHËRPOROSI MARRËSE E ÇMIMIT ME PËRPARËSI (SHITJE/BLERJE) DHE RENDITJEN E TYRE SIPAS PRIORITETIT NË TREGJET E ANKANDEVE TË DITËS NË AVANCË DHE BRENDA SË NJËJTËS DITË NË BURSËN SHQIPTARE TË ENERGISË ELEKTRIKE.

Portofolet e Anëtarëve të Bursës që duhet të vendosin Urdhërporosi Marrëse e Çmimit me Përparësi Blerjeje, do të renditen sipas prioriteteve të mëposhtme:

1. Sasia e energjisë e vendosur si Urdhërporosi nga Portofoli i Operatorit të Sistemit të Transmetimit SH.A për blerjen e humbjeve do të renditet e para në kurbën e grupuar të blerjeve.
2. Sasia e energjisë e vendosur si Urdhërporosi nga Portofoli i Operatori i Sistemit të Shpërndarjes SH.A për blerjen e humbjeve do të renditet e dyta në kurbën e grupuar të blerjeve.
3. Sasia e energjisë e vendosur si Urdhërporosi nga Portofoli i Furnizuesit të Shërbimit Universal SH.A për volumet sipas kontratës dypalëshe me Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare SH.A në kuadër të detyrimit të shërbimit universal do të renditet e treta në kurbën e grupuar të blerjeve.
4. Sasia e energjisë e vendosur si Urdhërporosi nga Portofoli i Palës Blerëse në kontratën dypalëshe (OTC – Over the Counter) që duhet të tregtohen në Bursë do të renditet e katërta në kurbën e grupuar të blerjeve.

Portofolet e Anëtarëve të Bursës që duhet të vendosin Urdhërporosi Marrëse e Çmimit me Përparësi Shitjeje sipas prioriteteve:

1. KESH Sh.A, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara nga aktet ligjore, nënligjore dhe rregullatore për kundrejt shoqërive publike (OST, OSSH, FSHU dhe FTL) do të vendosi se cila pjesë e sasisë ose e gjithë sasia e energjisë së prodhuar për këtë detyrim do të vendoset si Urdhërporosi Marrëse e Çmimit me Përparësi Shitjeje nëpërmjet Portofoleve të krijuara për këtë qëllim.
2. Sasia e energjisë e vendosur si Urdhërporosi nga Portofoli i Operatorit të Burimeve të Rinovueshme (REO)/ Furnizuesi i Tregut të Lirë SH.A (FTL) për shitjen e energjisë që do të prodhohet nga prodhuesit me përparësi dhe që trajtohen me skema mbështetëse (Feed-in Tariff) do të renditet e para në kurbën e grupuar të shitjeve.
3. Sasia e energjisë e vendosur si Urdhërporosi nga Portofoli i Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare SH.A për shitjen e energjisë që do të prodhohet në rastet e shkarkimit të detyruar të kaskadës do të renditet e dyta në kurbën e grupuar të shitjeve.
4. Sasia e energjisë e vendosur si Urdhërporosi nga Portofoli i gjeneruesëve të BRE-ve që duhet të tregtohen në Bursë nga gjeneruesit që trajtohen me skema Kontrata për Diferencë (CfD) për shitjen e energjisë së prodhuar do të renditet e treta në kurbën e grupuar të shitjeve.

RREGULLAT E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

ANEKS NR. 4

RREGULLI PËR PËRCAKTIMIN E URDHËRPOROSIVE FITUESE NË RASTIN KUR NJË SEGMENT I GRUPUAR I URDHËRPOROSIVE SHITJEJE/BLERJEJE DO TË PRANOHET PJSËRISHT.

1. Përcaktimi i fituesit/eve, në rastin kur një segment i grupuar i Urdhërporosive Shitjeje/Blerjeje do të pranohet pjesërisht për tregtim, do të zbatohet sipas parimit të rregullit “I pari në rradhë, i pari në shërbim”.

RREGULLAT E TREGUT TË ENERGISË ELEKTRIKE

ANEKS NR. 5

ALOKIMI I PORTOFOLIVE TË VEÇANTA NË BURSËN SHQIPTARE TË ENERGISË ELEKTRIKE PËR GJENERUESIT ME KAPACITET TË INSTALUAR TË BARABARTË OSE MË TË MADH SE 5 MW.

1. ALPEX sh.a. do të alokojë portofole të veçanta të tregimit për të gjithë gjeneruesit me kapacitet të instaluar të barabartë ose më të madh se 5 MW, pavarësisht se këto kapacitete gjeneruese mund ti përkasin të njëjtit Anëtar Burse (apo kompanie) që menaxhon, administron dhe shfrytëzon disa kapacitete gjeneruese.

RREGULLAT E TREGUT TË ENERGISË ELEKTRIKE

ANEKS NR. 6

TREGTIMI I KONTRATAVE TË LIDHURA NDËRMJET DY PJESËMARRËSVE TË TREGUT JASHTË BURSËS (OVER THE COUNTER - OTC) NË BURSËN SHQIPTARE TË ENERGISË ELEKTRIKE, MIDIS SHOQËRIVE QË NUK JU ËSHTË VENDOSUR DETYRIMI PËR SHËRBIMIN PUBLIK.

1. Kontratat e brendshme afatgjata dypalëshe (Over the Counter - OTC) midis shoqërive që nuk ju është vendosur detyrimi për shërbimin publik, të cilat do të bazohen në një kontratë financiare, ku energjia elektrike fizike do të tregtohet nëpërmjet Bursës, do të prezantohen për tregtim në Bursë në një moment të dytë nga fillimi i operacionalizimit të Bursës Shqiptare të Energjisë, por jo më vonë se data 29/02/2024.
2. Shoqëria ALPEX sh.a. pasi të vlerësojë se është garantuar likuiditeti dhe janë krijuar kushtet e nevojshme, do të informojë paraprakisht Autoritetet Rregullatore, anëtarët e bursës dhe palët e interesuara për fillimin e tregtimit të kontratave të përcaktuara në pikën 1.

RREGULLAT E TREGUT TË ENERGISË ELEKTRIKE

ANEKS NR. 7

PRODUKTET DHE LLOJET E URDHËRPOSIVE QË DO TË TREGTOHEN FILLIMISHT NË BURSËN SHQIPTARE TË ENERGISË ELEKTRIKE

1. Me fillimin e operimit të tregut nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, për një periudhë tranzitore, por jo më vonë se data 29.02.2024, do të tregtohen produkte orare nëpërmjet urdhërporosisë të llojit “Urdhërporosi e Thjeshtë”.
2. Shoqëria ALPEX sh.a. do të informojë paraprakisht Autoritetet Rregullatore, anëtarët e bursës dhe palët e interesuara, në momentin e prezantimit të produkteve dhe llojeve të urdhërporosive të tjera për tregtim në Bursën Shqiptare të Energjisë, sipas parashikimeve në Procedurën e Tregimit të Rregullave të Tregut të Energjisë.